

## Partizani/ Cmime te lira per tifozet qe shkojne ne Korce

nga AlbaniaSoccer  
E enjte, 31 Tetor 2013 23:53

---



Drejtuesit e Partizanit duke dashur te kene sa me shume tifozet ne mbeshtetje ne ndeshjen me Skenderbeun kane menduar te ulin cmimin e biletave te autobuzeve dhe stadiumit. Ne nje komunikate per tifozet, Partizani ka njoftuar detajet e udhetimit dhe cmimin. "Per tifozat qe deshirojne te shoqerojne ekipin ne transferten e Korçes klubi organizon transportin dhe shitjen e biletave te ndeshjes qe ne Tirane. Çmimi i biletës do te jete 500 leke (te reja) dhe perfshin udhetimin vajtje-ardhje ne Korçe me autobuzat e vena ne dispozicion nga Klubi si dhe hyrjen ne stadium. Personat pa biletën e ndeshjes nuk mund te hipin ne ato autobuza. Autobuzat do te nisen dite e Shtune, date 2 Nentor, ora 12:00 nga Pallati i Sportit. Biletat dalin ne shitje nga dita e Premte, ora 9:00, ne piken e biletave prane pallateve 9-kateshe", thuhej ne deklaraten e klubit te kuq drejtuar tifozëve te Partizanit.